

VENDIM
Nr. 55, datë 27.1.2016

PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT
(Ndryshuar me VKM nr.399 datë 27.01.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 62, 97, 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit, sipas albumit me 54 faqe, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë përcaktuar në lidhjen nr. 1, të albumit.

3. Simbolet e Policisë së Shtetit janë flamuri dhe stema, të përcaktuara e të përshkruara në lidhjen nr. 2 të albumit.

4. Llojet e uniformës, që do të kenë në përdorim punonjësit e Policisë së Shtetit, do të jenë:

4.1 Uniforma bazë në detyrë:

a) dimërore;

b) verore.

4.2 Uniforma për stërvitje e shërbime;

4.3 Uniformat e veçanta;

4.4 Uniforma ceremoniale;

4.5 Veshja civile, e cila konvertohet në vlerë monetare.

4.6. *Uniformë civile për zyrat e pritjes së qytetarëve në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, sipas modelit në lidhjen nr. 3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi;*

Llojet e uniformave të përshkruara në pikat 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4, 4.6 të këtij vendimi, janë përcaktuar në lidhjen nr. 3, të albumit.

5. Shenjat dalluese të Policisë së Shtetit janë:

5.1 Shenja e mbiemrit/numri i identifikimit;

5.2 Shenja e kapelës;

5.3 Shenjat që vendosen në objektet e uniformës, sipas shërbimeve të Policisë së Shtetit, të përcaktuara si më poshtë vijon:

a) Shenja e krahut e Policisë së Rendit;

b) Shenja e krahut për Shqiponjat;

c) Shenja e krahut e Policisë së Kufirit dhe Migracionit;

ç) Shenja e krahut e Policisë Rrugore;

d) Shenja e krahut e Forcave Speciale “RENEA”;

dh) Shenja e krahut e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë;

e) Shenja për kursantë/studentë;

ë) Shenja e jakës, përkrenare e Skënderbeut e stilizuar;

f) Shiriti i kapelës dhe kopsat me ngjyrë “të artë”.

Shenjat dalluese, të cituara më sipër, përcaktohen në lidhjen nr. 4 të albumit.

6. Ministri i Punëve të Brendshme, me urdhra apo udhëzime, miraton:

6.1 Normat e furnizimit me veshmbathje të punonjësve të Policisë së Shtetit;

6.2 Rregulloren e uniformës së punonjësve të Policisë së Shtetit;

6.3 Ndryshimet e mundshme të elementeve të veçanta të uniformës dhe shenjave dalluese etj., sipas ndryshimeve të strukturës e perspektivës së policisë, pa prekur, në tërësi, themelin e tyre;

6.4 Normat me veshje civile të punonjësve të Policisë, që trajtohen me këtë veshje, kompensimin e tyre në vlerë monetare;

6.5 Normat e materialeve të veshmbathjes, që janë në inventar të njësive shpenzuese;

6.6 Normat e pajisjeve për qentë e policisë;

6.7 Normat e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes;

6.8 Normat e veshmbathjes së posaçme dhe të rrobave të punës, falas;

6.9 Normat e veshmbathjes së punonjësve të Policisë së Shtetit që shkojnë me misione jashtë shtetit etj.

6.10 periudhën tranzitore të përdorimit të uniformës që është në përdorim dhe të uniformës së re, që do të miratohet.

7. Drejtori i Policisë së Shtetit ka në kompetencë të miratojë:

7.1 Specifikimet dhe kushtet teknike të zbatimit të objekteve të uniformës, shenjave dhe elementeve të tjera të Policisë së Shtetit;

7.2 Zëvendësimin e materialeve të objekteve të uniformës, brenda vlerës së normës.

8. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

9. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit janë të patjetërsueshme. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të institucioneve apo subjekteve të tjera që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtin mision dhe detyra që ka Policia e Shtetit.

10. Vendimi nr. 79, datë 21.1.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e stemës, të uniformës, gradave, emblemës, flamurit dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

11. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit”.

12. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



This image cannot currently be displayed.

PARATHËNIE

“Uniformat e policisë si vlerë shpirtërore e një kombi, si vlera më e rëndësishme e Policisë së Shtetit”.

Përdorimi i uniformës përbën prezantimin publik të strukturave të Policisë së Shtetit. Kjo sjell detyrime si në mënyrën e paraqitjes së uniformës ashtu dhe në qëndrimin dhe veprimin personal të mbajtësit.

2

PËRMBAJTJA

LIDHJA Nr. 1

PARAQITJA, FORMA DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË GRADAVE TË POLICISË SË SHTETIT.. F. 4 – 14

LIDHJA Nr. 2

SIMBOLET E POLICISË SË SHTETIT. F. 15 – 17

LIDHJA Nr. 3

LLOJET E UNIFORMAVE TË POLICISË SË SHTETIT. F. 18 – 44

LIDHJA Nr. 4

SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT..... F. 45 – 54

3

GRADAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 1

4

Shënim: Në lidhjen nr. 1, në faqet 5 e 6, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- i) Përmasat “...60 mm x 58 mm...” zëvendësohen me “...60 mm x 52 mm...; ”*
- ii) Fjalët “...përzierja; 67% pambuk – 33% fibër poliestër +/- 3%...” zëvendësohen me “...përzierja; 50% pambuk – 50% fibër poliestër +/- 3%...; ”*
- iii) Fjalët “Pesha e tekstilit 125 g/m² +/- 5 g...” zëvendësohen me “Pesha e tekstilit 220 g/m² +/- 5 g...; ”*


iv) Pas fjalëve “...material plastik...” shtohen “...përveç gradave të mëdha të spaletit ceremonial, të cilat i kanë elementet brenda gradës metalike ngjyrë ari, dhe...;




This image cannot currently be displayed.

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI "NËNKOMISAR"

Fig. Nr. 2:



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALI "NËNKOMISAR"




GRADË E VOGËL GJOKSI "NËNKOMISAR"



8

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI "KRYEKOMISAR"

Fig. Nr. 4:



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE "KRYEKOMISAR"




GRADË E VOGËL GJOKSI "KRYEKOMISAR"



10

GRADË E MADHE SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES I LARTË”



GRADË E MADHE SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES I LARTË”



GRADË E VOGËL GJOKSI “DREJTUES I LARTË”



SIMBOLET E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 2

15

FLAMURI I POLICISË SË SHTETIT



Pjesa valëvitëse e flamurit:

Drejtëndësh me përmasa me raport 1:1,4, i ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe. Në qendër shqiponja dykrenare sipas modelit të flamurit kombëtar, e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta e kuqe dhe e zezë. Mbi shqiponjën, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut, me ngjyrë të artë, e stilizuar sipas figurës.

Poshtë shqiponjës, shkrimi “POLICIA E SHTETIT” i artë.

Pjesa jovalëvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, sipas figurës, ngjyrë ari.

16

STEMA E POLICISË SË SHTETIT



Stema e Policisë së Shtetit përbëhet:

Mburojë (Shqyt), e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe. Në qendër të shqytit shqiponja dykrenare me përkrenaren e Skënderbeut të vendosur sipër saj, të dyja me relief dhe të stilizuara sipas figurës. Në gjoks të shqiponjës një mburojë (shqyt) e vogël, e kuqe, me në qendër shqiponjën e zezë të flamurit kombëtar.

Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit), shkrimi **‘POLICIA E SHTETIT’** ngjyrë ari.

Përreth mburojës (shqytit) kornizë ari.

17

UNIFORMAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 3

18

INDEKSI

1. UNIFORMA BAZË NË DETYRË DIMËRORE

- 1 Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)
- 2 Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)
- 3 Kostum uniforme për meshkuj/femra (1 Xhakete, 2 palë pantallona, 2 kapele)
- 4 Pulover e trikotuar jakë "V"
- 5 Këmishë bojë qielli me mëng të gjata, për meshkuj/ femra
- 7 Kravatë blu uniforme
- 8 Këpucë me qafa dimërore për meshkuj/ femra
- 9 Rrip pantalloni
- 10 Rrip multifunksional
- 11 Jelek multifunksional
- 12 Pelerinë shiu
- 13 Doreza lëkure

3. UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME

- 1 Kostum doku stërvitje (Xhakete, pantallona, kapele tip sport).
- 2 Bluzë pambuku, jakë rrumbullakët m/ gjata
- 3 Bluzë pambuku, jakë rrumbullakët m/ shkurtra
- 4 Këpucë me qafa stërvitje (Kambale)

5. UNIFORMA CEREMONIALE

- 1 Këmishë ceremoniale femra/ meshkuj
- 2 Rrip ceremoniali
- 3 Doreza të bardha ceremoniale

2. UNIFORMA VERORE

- 1 Pantallona vere për meshkuj/ femra
- 2 Këmishë bojë qielli me mëng të shkurtra, për meshkuj/ femra
- 3 Bluzë blu pambuku me 2 kopsa, me mëng të shkurtra
- 4 Këpucë gjysma verore për meshkuj/ femra

4. UNIFORMAT E VECANTA

- 1 Uniforma e Policisë Rrugore. Uniformë dimërore dhe verore), Jelek fosforeshent, Mbulesë kapele, Doreza motoçiklisti,
- 2 Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe, gjatë sezonit turistik. Bluzë pambuku e bardhë m/sh, Pantallona të shkurtra, këpucë tip atlete, kapele sport
- 3 Uniforma e veçantë për Punonjësit e Policisë Seksioni i Forcës së Posaçme SHQIPONJA dhe të Njësisë së Ndërhijës së Patrullave me motoçikleta. (Uniformë dimërore dhe verore)
- 4 Uniforma e veçantë për punonjësit e Policisë së Rendit, patrullë e përgjithshme (Unif. dimërore /verore)
- 5 Uniforma e Forcave Speciale "RENEA".
- 6 Uniformat e Ndërhijës së Shpejtë (Kostum doku shërbimi,)
- 7 Uniforma për punonjësit e Policisë të Mjeteve Ujore: Jelek shpëtimi fosforeshent.
- 8 Uniforma e Prezantimit të Policisë së Hetimit të Krimit: Jelevu prezantues , Kapele prezantuese.
- 9 Veshje të ngrohta: Pulover leshi e trikotuar jakë rrumbullakët, Kapuç leshi i trikotuar

19

UNIFORMA BAZË DIMËRORE NË DETYRË

1. XHUP SHËRBIMI ¾ (ME VESHJE TË NGROHTË)



2. XHUP SHËRBIMI (ME VESHJE TË NGROHTË)



20

UNIFORMA E SHËRBIMIT

3. KOSTUM UNIFORME PËR MESHKUI

•XHAKETË, PANTALLONA, KAPELE



3.1.KOSTUMI I UNIFORMËS PËR FEMRA

•XHAKETË, PANTALLONA/ FUND, KAPELE



21

KËMISHË BOJË OIELLI M/GJATA MESHKUI



KËMISHË BOJË OIELLI M/GJATA FEMRA



KRAVATATË UNIFORME BLU



PULOVËR E TRIKOTUAR JAKË "V"



KËPUÇË ME QAFÄ DIMËRORE PËR MESHKUI DHE FEMRA



DORËZA LËKURE



RRIP PANTALLONI UNIFORME



RRIP MULTIFUNKSIONAL



22

PELERINĂ SHIU



24

UNIFORMA VERORE

PANTALLONA VERE
MESHKUJ



PANTALLONA/FUND
VERE FEMRA



KËMISHË BOJË QIELLI
M/SHKURTRA MESHKUJ



KËMISHË BOJË QIELLI
M/SHKURTRA FEMRA



BLUZË PAMBUKU BLU, ME 2 KOPSA ME MËNG
TË SHKURTRA.



KËPUÇË ¼ VERE
MESHKUJ



KËPUÇË ¼ VERE
FEMRA



KËPUÇË ¼ ME
QAFË, SHËRBIMI



25

UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME

- KOSTUM DOKU (RIP STOP)
- XHAKETË
- PANTALLONA
- KAPELE TIP SPORT



BLUZË PAMBUKU ME JAKË
TË RRUMBULLAKËT, ME
MËNG TË GJATA



BLUZË PAMBUKU ME JAKË TË
RRUMBULLAKËT, ME MËNG TË SHKURTRA



26

UNIFORMAT E VECANTA

1. UNIFORMA E POLISË RRUGORE

DIMERORE KOSTUM MOTOÇIKLISTI (XHUP, PANTALLONA)



•1.1 UNIFORMA VERORE TË POLICISË RRUGORE

BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU



Shënim: Shtuar me VKM nr.399 datë 1.06.2016

Lidhja nr.3/a

UNIFORMA PËR ZYRAT E PRITJES SË QYTETARËVE



Shënim: Ndryshuar dhe shtuar me VKM nr. 399 datë 1.06.2016.

b) Në lidhjen nr. 3, në faqet 27, 31 dhe 32, shtohet pjesa e uniformës së veçantë, si më poshtë vijon:

i) “Bluzë pambuku me 3 kopsa, me mëngë të gjata, ngjyrë blu”, sipas modelit në lidhjen nr. 3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii) “Këpucë vere”, sipas modelit në lidhjen nr. 3/c, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

Lidhja nr.3/b

BLUZË PAMBUKU ME 3 KOPSA ME MËNGË TË GJATA, NGJYRË BLU



KËPUÇË VERE PËR SHËRBIMET E VEÇANTA



XHUP FOSFORESHENT




JELEK FOSFORESHENT



ARTIKUJ TË POLICISË RRUGORE

MBULESË KAPELE



**MËNGORE
FOSFORESHENTE**



DOREZA MOTOÇIKLISTI



29

2. UNIFORMA E VECANTË VERORE PËR PUNONJËSIT E POLICISË OË KRYEJNË SHËRBIMIN NË PLAZHE, GJATË SEZONIT TURISTIK.

- BLUZË ME DY KOPSA E BARDHË ME MËNG TË SHKURTRA
- PANTALLONA TË SHKURTRA PËR MESHKUJ/FEMRA
- KËPUCË TIP ATLETE
- KAPELE TIP SPORT



Meshkuj



Femra



30

3. UNIFORMA E VECANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SEKSIONI I FORCËS SË POSACME SHOIPONJA DHE TË NJESISE SE NDERHHYRJES SE PATRULLËS ME MOTOCIKLETA. (UNIFORMË DIMËRORE DHE VERORE)

KOSTUM MOTOÇIKLISTI (Xhup, pantallona)

•BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU



31

4. UNIFORMA E VECANTE PER PUNONJESIT E POLICISE SË RENDIT, PATRULLË E PËRGJITHSHME

• UNIFORMA DIMËRORE XHUP, PANTALLONA

•UNIFORMA VERORE, BLUZË PAMBUKU M/SH ME 2 KOPSA, PANTALLONA DOKU + KAPELE SPORT



32

4. UNIFORMA E FORCAVE SPECIALE **“R E N E A”**

- I. UNIFORMË OPERACIONALE DIMËRORE
- II. UNIFORMË OPERACIONALE PRANVERË – VJESHTË
- III. UNIFORMË OPERACIONALE VERORE
- IV. AKSESORË

33

•UNIFORMË OPERACIONALE DIMRI

KOMINOSHE OPERACIONALE



•XHUP DIMRI



•KAPELE OPERACIONALE



•KEPUCË TAKTIKE E FORCAVE SPECIALE



•DOREZA TAKTIKE DIMRI



34

II. UNIFORMË OPERACIONALE PRANVERË - VJESHTË

**•XHUP TAKTIK
PRANVERË - VJESHTË**



**•KOMINOSHE
PRANVERË - VJESHTË**



**•KËPUÇË
PRANVERË – VJESHTË**



**•DOREZA TAKTIKE
PRANVERË - VJESHTË**



35

III. UNIFORMË OPERACIONALE VERORE

BLUZË TAKTIKE VERE



**PANTALLONA
TAKTIKE VERE**



XHAKETË TAKTIKE VERE



KËPUÇË TAKTIKE VERE



RRIP TAKTIK



MASKË OPERACIONALE



36

JELEK OPERACIONAL (CIVIL)



PANTALLONA OPERACIONALE (CIVILE)



37

UNIFORMAT E NDËRHYRJES SË SHPEJTË

KOSTUM DOKU (RIP-STOP)
(XHAKETË, PANTALLONA
DHE KAPELE)



BLUZË PAMBUKU
BLU ME DY KOPSA



PANTALLONA DOKU
ME RIP STOP



38

7. UNIFORMA E VEÇANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË TË MJETEVE UJORE

JELEK SHPËTIMI FOSFORESHENT



39

8. UNIFORMA E PREZANTIMIT TË POLICISË SË HETIMIT TË KRIMIT.

•JELEK PREZANTUES HETIMI I KRIMIT



•KAPELE PREZANTUESE HETIMI I KRIMIT



40

VESHJE E NGROHTË PËR ZONAT VERIORE DHE JUGLINDORE

PULOVËR LSHI E TRIKOTUAR



KAPUÇ LSHI I TRIKOTUAR



41

RRIP CEREMONIAL



KËMISHË CEREMONIAL M/F



DOREZA CEREMONIALI



42


Shënim: Shtuar lidhja 3/d me VKM nr. 399 datë 1.06.2016

Lidhja nr.3/d

KOSTUMI CEREMONIAL PER TRUPEN CEREMONIALE



KORDONE PER UNIFORMEN CEREMONIALE



43

SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT

LIDHJA 4

44

SHENJA MBIEMRI, NUMER IDENTIFIKIMI

ABCD

11709

45

•SHENJA E KAPELES, (EMBLEMA)



Shqiponjë dykrerëshe me përkrenaren e Skendërbeut, të vendosur sipër saj. E gjitha e artë, me relief dhe e stilizuar sipas figurës.

46

Shënim: Ndryshuar me VKM nr.399 datë 1.06.2016

Në lidhjen nr. 4, në faqen 47, fjalët “Në pjesën e poshtme...”, zëvendësohen me “Në pjesën e sipërme...”.

SHENJAT SIPAS SHËRBIMEVE TË POLICISË

□ SHENJË KRAHU POLICIA E RENDIT



Mburojë (Shqyt) e ndarë vertikalisht në dy pjesë, e kuqe dhe e zezë, me kornize të artë. Në pjesën e poshtme të mburojës (shqytit), janë të shkruara fjalët “**POLICIA E RENDIT**” të arta. Brenda mburojës (shqytit), një mburojë (shqyt) më e vogël blu me kornizë të artë. Brenda tij në qendër, e vendosur një shpatë e argjendtë e vendosur vertikalisht dhe përkrenarja e Skenderbeut e artë.

47

☐ SHENJË KRAHU PER SHQIPONJAT



Mburojë (Shqyt) e kuqe me në qendër kokë shqiponje e zezë me shikim majtas, me sqep dhe gjuhë të artë. Në pjesën e sipërme të shqytit, fjala “SHQIPONJAT” e artë.
Në 1/3 e poshtme të shqytit, trekendesha blu e kuq të ndërthurur.

48

☐ SHENJË KRAHU POLICIA RRUGORE



Mburojë (Shqyt) e zezë me kornizë të kuqe. Në pjesën e sipërme të shqytit motiv shahu bardhë e zi. Në pjesën e poshtme të mburojës (shqytit), fjalët “POLICIA RRUGORE” ngjyrë e verdhë fluoreshente.
Në qendër, një mburojë (shqyt) më e vogël ngjyrë e verdhë fluoreshente me një pishtar blu me flakë të kuqe dhe një rrotë.

49

SHENJË KRAHU POLICIA KUFIRIT DHE MIGRACIONIT



Mburojë (Shqyt) e zezë, me kornizë të artë. Në pjesën e sipërme, në fushë të kuqe fjalët **“POLICIA KUFITARE”** me ngjyre ari. Në cepin e poshtëm, përkrenarja e Skënderbeut e stilizuar e artë. Në qendër një mburojë (shqyt) më i vogël e blertë, me hartën e Shqipërisë ngjyrë gri.

50

SHENJE KRAHU E FORCAVE SPECIALE



Mburojë (Shqyt) e kuqe me kornizë të artë, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë. Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri, që shtrëngon një rrufe të artë. Poshtë, në shirit horizontal blu, inicialet **“RENEA”** të arta.

51

SHENJË KRAHU E NDËRHYRJES SË SHPEJTË




Mburojë (Shqyt) e kuqe me kornizë të artë, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.
Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri, që shtrëngon një shigjetë të artë me majën lart. Poshtë, në shirit horizontal blu, inicialet “FNSH” të arte.


52

SHENJA PËR KURSANTË/ STUDENTE

Fig. Nr. 1:



SHENJË CEREMONIALI KURSANTI/STUDENTI



SHENJË GJOKSI KURSANTI/STUDENTI



53

SHENJA E JAKËS PËRKRENARE E STILIZUAR



KOPSAT

Kopsa të vogla,
Ø 15 mm



Kopsa të mesme,
Ø 23 mm



Kopsa të mëdha, Ø 25 mm



SHIRITI I ZIL KAPELES

